

LIGJ
Nr. 69/2026

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9244, DATË 17.6.2004,
“PËR MBROJTJEN E TOKËS BUJQËSORE”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 2, pas pikës 11 shtohen pikat 12, 13, 14 dhe 15 me këtë përmbajtje:

“12. “**Aeroponia**” është teknika e kultivimit të bimëve, duke i mbajtur rrënjët e tyre të varura në hapësirë, në të cilën aplikohet periodikisht ose pa ndërprerje tretësirë ushqimore në formë pluhuri.

13. “**Akuaponia**” është një sistem i integruar bujqësie dhe akuakulture, që kombinon rritjen e organizmave ujorë, peshq ose kultura të tjera ujore, si dhe kultivimin e bimëve në një cikël të mbyllur, ku mbetjet e organizmave ujorë përdoren si lëndë ushqyese për bimët, ndërsa bimët ndihmojnë në pastrimin e ujit për organizmat ujorë.

14. “**Hidroponia**” është teknika e kultivimit të bimëve në tretësirë ujore, e cila mund të përfshijë substrat inorganik, si: rërë, granil, perlit, lesh guri, gur vullkanik, ose organik, si: torfë, lëvoret e drurëve, lëvoret e arrës së kokosit, kashtë orizi.

15. “**Akuakulturë**” ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 103/2016, “Për akuakulturën”, i ndryshuar.”.

Neni 2

Në nenin 14 bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në pikën 5 bëhen shtesat dhe ndryshimi si më poshtë:

i. Në shkronjat “b” dhe “c”, pas fjalës “shpërndarjen” shtohet fjala “depozitim”;;

ii. Shkronja “d” ndryshohet si më poshtë:

“d) ndërtimi i infrastrukturës, duke përfshirë struktura dhe sisteme që mbështesin zhvillimin e aktiviteteve të aeroponisë, akuaponisë, hidroponisë dhe akuakulturës.”;

b) Pas pikës 5 shtohen pikat 6 dhe 7 me këtë përmbajtje:

“6. Këshilli i Ministrave përcakton kriteret për përdorimin e tokës bujqësore për kryerjen e aktivitetit agrifotovoltaik, sipas përcaktimeve të këtij neni, dhe të atij eolik në tokat bujqësore me bonitet deri në 8, procedurat për monitorimin e ushtrimit të aktivitetit, përfshirë masat për shkelje të kushteve të ushtrimit të aktivitetit, si dhe tarifën që paguajnë subjektet që tregtojnë energjinë e prodhuar në centralet e energjisë së rinovueshme agrifotovoltaike në toka bujqësore. Tarifa transferohet në programin për bujqësinë dhe zhvillimin rural për mbështetjen e bujqësisë.

7. Kriteret për përdorimin e tokës bujqësore për kryerjen e aktiviteteve të aeroponisë, akuaponisë, hidroponisë dhe akuakulturës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë.”.

Neni 3
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë vendimin në zbatim të nenit 2 të tij.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.7.2026.

Shpallur me dekretin nr. 438, datë 29.7.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.